


Indeksi i Çmimeve të Prodhimit

Tremujori II, 2019

Tiranë, më 04 Shtator 2019: Në tremujorin e dytë të vitit 2019, Indeksi i Çmimeve të Prodhimit arriti 103,2 duke shënuar një ulje me 0,3 % në krahasim me tremujorin e dytë 2018.

Indeksi i Çmimeve të Prodhimit, në tremujorin e dytë 2019, shënoi rritje me 0,1 % krahasuar me tremujorin e parë 2019.

Fig. 1 Indeksi i Çmimeve të Prodhimit



Ndryshimi vjetor: Indeksi i Çmimeve të Prodhimit në seksionin “Industri përpunuese” në tremujorin e dytë 2019, ka shënuar ulje me 1,1 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2018, brenda këtij seksioni ulja më e madhe vërehet në aktivitetin “Metalurgjia” me 7,4 %, pasuar nga aktivitetet “Përpunimi i produkteve ushqimore” me 1,3 % dhe “Prodhimi i produkteve minerale jo metalike” me 0,1 %. Indeksi i Çmimeve të Prodhimit, në seksionin “Industri Nxjerrëse” ka shënuar ulje me 0,4 %, brenda këtij seksioni ulja më e madhe vërehet në aktivitetin “Nxjerrja e naftës bruto dhe gazit natyror” me 1,1 %.

Indeksi i Çmimeve të Prodhimit për Produktet Vendase: Krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2018, indeksi shënoi një rritje me 0,8 %, e ndikuar kryesisht nga rritja prej 3,0 % në seksionin “Industri nxjerrëse”.

Indeksi i Çmimeve të Eksportit: Krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2018, indeksi shënoi një ulje prej 3,3 %. Ulja më e madhe prej 2,6 % vërehet në seksionin “Industria përpunuese”.

Ndryshimi tremujor: Indeksi i Çmimeve të Prodhimit, krahasuar me tremujorin e parë 2019, shënoi rritje me 0,1 %. Rritja më e madhe prej 5,2 % vërehet në seksionin “Industri Nxjerrëse” pasuar nga seksioni “Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar” me 0,1 %. Ndërsa indeksi në seksionin “Industri përpunuese” ka shënuar ulje me 1,1 %, ku mund të veçojmë uljen në aktivitetet: “Metalurgjia” me 7,5 %, “Përpunimi i produkteve ushqimore” me 0,4 % dhe “Prodhimi i produkteve minerale jo metalike” me 0,2 %.

Indeksi i Çmimeve të Prodhimit për Produktet Vendase: Krahasuar me tremujorin e parë 2019, indeksi shënoi një rritje me 0,4 %, e ndikuar kryesisht nga rritja prej 4,1 % në seksionin “Industri nxjerrëse”.

Indeksi i Çmimeve të Eksportit: Krahasuar me tremujorin e mëparshëm, indeksi shënoi një ulje me 0,7 %, ndikimin kryesor në këtë ulje e kanë dhënë çmimet e prodhimit të produkteve në seksionin “Industri Përpunuese” me 2,6 %.

Tab. 1 Indeksi i Çmimeve të Prodhimit

2010=100

NVE	Përshkrimi	Peshat	Prill-19	Maj-19	Qershor-19	II -19
	Gjithsej	100,0	103,6	103,6	102,6	103,2
B	Industri Nxjerrëse	12,0	119,4	119,6	111,7	116,9
06	Nxjerrja e naftës bruto dhe gazit natyror	5,7	130,7	132,4	115,2	126,1
07	Nxjerrja e mineraleve metalore	4,7	100,3	98,5	100,6	99,8
08	Nxjerrja e mineraleve të tjera nga minierat apo karrierat	1,7	108,5	108,7	108,4	108,5
C	Industri Përpunuese	51,6	103,5	103,4	103,4	103,5
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	9,4	103,5	103,5	103,0	103,3
11	Prodhimi i pijeve	1,9	105,4	105,6	105,4	105,4
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	0,1	97,9	97,9	97,9	97,9
13	Përpunimi i tekstileve	0,4	100,1	100,1	100,1	100,1
14	Konfeksionimi i veshjeve	4,2	107,4	107,5	107,6	107,5
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	4,4	107,2	107,4	107,4	107,3
16	Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobiljeve; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi	0,9	106,3	106,3	106,3	106,3
17	Prodhimi i letërës dhe produkteve prej letre	1,1	110,3	110,3	110,3	110,3
18	Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara	1,1	95,1	95,0	95,0	95,0
19	Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës	0,3	108,6	108,6	108,6	108,6
20	Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike	0,9	106,9	107,1	107,3	107,1
21	Përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutikë	1,2	96,1	96,2	96,2	96,2
22	Prodhimi i produkteve të kauçikut dhe plastikës	1,7	116,7	116,7	116,7	116,7
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	7,6	100,9	100,6	100,6	100,7
24	Metalurgjia	6,2	90,6	90,6	90,6	90,6
25	Prodhimi i produkteve metalike të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve	5,4	105,8	105,8	105,8	105,8
26	Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë	0,1	118,0	117,7	114,0	116,6
27	Prodhimi i paisjeve elektrike	0,4	99,9	99,9	99,9	99,9
28	Prodhimi i makinerive dhe paisjeve p,k,t	0,3	114,6	114,5	114,4	114,5
29	Prodhimi i mjeteve të transportit, rimorkiove dhe gjysëmrimorkiove	0,0	100,2	100,2	100,2	100,2
30	Pajisje të tjera transporti	0,0	105,0	105,0	105,0	105,0
31	Prodhimi i mobiljeve	3,0	114,2	114,1	114,2	114,2
32	Industri të tjera p,k,t	0,3	91,4	91,4	91,4	91,4
33	Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve	0,5	107,7	103,3	107,7	106,2
D	Energjia elektrike, gaz, avull dhe me ajër të kondicionuar	33,1	100,4	100,3	100,2	100,3
35	Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri kondicionuar	33,1	100,4	100,3	100,2	100,3
E	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	3,2	102,2	102,6	102,4	102,4
36	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	1,5	117,6	117,6	117,6	117,6
37	Shërbime të trajtimit të kanalizimeve	0,0	101,5	101,5	101,5	101,5
38	Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve	1,7	81,6	82,2	81,9	81,9

Tab. 2 Ndryshimet tremujore dhe vjetore të Indeksit të Çmimeve të Prodhimit

				%	
NVE	Përshkrimi	Peshat	II-19 / I-19	II-19 / II-18	
	Gjithsej	100,0	0,1	-0,3	
B	Industri Nxjerrëse	12,0	5,2	-0,4	
06	Nxjerrja e naftës bruto dhe gazit natyror	5,7	10,9	-1,1	
07	Nxjerrja e mineraleve metalore	4,7	-1,2	1,2	
08	Nxjerrja e mineraleve të tjera nga minierat apo karrierat	1,7	0,3	2,8	
C	Industri Përpunuese	51,6	-1,1	-1,1	
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	9,4	-0,4	-1,3	
11	Prodhimi i pijeve	1,9	0,2	0,7	
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	0,1	-1,2	-1,2	
13	Përpunimi i tekstileve	0,4	-1,4	-2,4	
14	Konfeksionimi i veshjeve	4,2	-0,8	1,1	
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	4,4	0,2	0,4	
16	Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobiljeve; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi	0,9	0,3	0,5	
17	Prodhimi i letërës dhe produkteve prej letre	1,1	3,1	2,8	
18	Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara	1,1	0,0	-1,3	
19	Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës	0,3	-0,1	1,6	
20	Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike	0,9	-0,8	-0,2	
21	Përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutikë	1,2	0,0	-1,0	
22	Prodhimi i produkteve të kauçikut dhe plastikës	1,7	-0,8	-1,7	
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	7,6	-0,2	-0,1	
24	Metalurgjia	6,2	-7,5	-7,4	
25	Prodhimi i produkteve metalike të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve	5,4	-0,3	-0,2	
26	Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë	0,1	0,4	-1,1	
27	Prodhimi i paisjeve elektrike	0,4	-2,3	-3,4	
28	Prodhimi i makinerive dhe paisjeve p,k,t	0,3	-0,2	2,1	
29	Prodhimi i mjeteve të transportit, rimorkiove dhe gjysëmrimorkiove	0,0	-0,6	-0,7	
30	Pajisje të tjera transporti	0,0	-0,2	0,6	
31	Prodhimi i mobiljeve	3,0	-0,2	-1,0	
32	Industri të tjera p,k,t	0,3	-1,0	-2,2	
33	Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve	0,5	0,3	1,3	
D	Energjia elektrike, gaz, avull dhe me ajër të kondicionuar	33,1	0,1	0,4	
35	Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri kondicionuar	33,1	0,1	0,4	
E	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	3,2	0,2	0,5	
36	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	1,5	0,0	0,0	
37	Shërbime të trajtimit të kanalizimeve	0,0	0,0	0,0	
38	Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve	1,7	0,5	0,9	

Tab. 3 Indeksi i Çmimeve të Prodhimit të produkteve për tregun vendas

		2010=100						
NVE	Përshkrimi	Peshat	Prill-19	Maj-19	Qershor-19	II-19	II-19 / I-19	II-19 / II-18
	Gjithsej	100,0	101,8	101,9	101,3	101,7	0,4	0,8
B	Industri Nxjerrëse	9,9	120,6	121,7	115,5	119,3	4,1	3,0
06	Nxjerrja e naftës bruto dhe gazit natyror	4,5	131,3	133,4	120,1	128,3	8,7	-0,3
07	Nxjerrja e mineraleve metalore	3,4	114,9	114,9	115,4	115,0	-0,9	1,1
08	Nxjerrja e mineraleve të tjera nga minierat apo karrierat	2,0	110,0	110,5	110,0	110,2	0,6	3,4
C	Industri Përpunuese	41,9	101,9	101,8	101,8	101,8	0,0	-0,1
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	9,4	105,6	105,6	104,9	105,4	-0,2	-1,9
11	Prodhimi i pijeve	2,3	105,1	105,4	105,2	105,2	0,4	0,9
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	0,1	100,0	100,0	100,0	100,0	0,0	0,0
13	Përpunimi i tekstileve	0,3	86,8	86,8	86,8	86,8	-0,4	0,3
14	Konfeksionimi i veshjeve	1,7	107,6	107,6	107,6	107,6	-0,3	0,5
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	1,8	109,3	109,8	109,8	109,6	-0,1	-0,2
16	Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobiljeve; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi	0,9	106,1	106,1	106,1	106,1	0,7	0,0
17	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrë	0,0	96,5	97,6	97,6	97,2	1,1	3,1
18	Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara	1,5	95,1	95,0	95,0	95,0	0,0	-1,3
19	Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës	0,1	98,6	98,6	98,6	98,6	0,0	0,0
20	Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike	0,7	97,4	97,6	98,0	97,7	-1,3	-0,5
21	Përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutikë	1,6	96,7	96,7	96,7	96,7	0,0	-0,7
22	Prodhimi i produkteve të kauçikut dhe plastikës	1,8	112,9	112,9	112,9	112,9	-1,0	-1,6
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	8,3	89,8	89,8	89,8	89,8	0,1	0,6
24	Metalurgjia	1,7	89,5	89,5	89,5	89,5	0,0	2,2
25	Prodhimi i produkteve metalike të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve	5,2	98,3	98,3	98,3	98,3	0,2	1,4
26	Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë	0,0	113,9	113,3	106,8	111,3	3,0	2,0
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	0,1	105,7	105,7	105,7	105,7	-0,1	-0,8
28	Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve p,k,t	0,1	114,9	114,8	114,8	114,8	-0,5	5,7
29	Prodhimi i mjeteve të transportit, rimorkiove dhe gjysmë rimorkiove	0,0	98,3	98,3	98,3	98,3	-0,2	-1,3
30	Pajisje të tjera transporti	0,1	102,3	102,3	102,3	102,3	-0,2	0,6
31	Prodhimi i mobiljeve	3,3	118,3	118,3	118,4	118,3	-0,1	-1,1
32	Industri të tjera p,k,t	0,1	94,3	94,3	94,3	94,3	-0,5	-1,5
33	Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve	0,7	116,3	111,6	116,3	114,7	0,3	1,3
D	Energjia elektrike, gaz, avull dhe me ajër të kondicionuar	45,3	100,4	100,3	100,2	100,3	0,1	0,4
35	Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri kondicionuar	45,3	100,4	100,3	100,2	100,3	0,1	0,4
E	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	2,9	108,4	108,4	108,4	108,4	0,0	0,0
36	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	2,1	117,6	117,6	117,6	117,6	0,0	0,0
37	Shërbime të trajtimit të kanalizimeve	0,0	101,5	101,5	101,5	101,5	0,0	0,0
38	Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve	0,8	79,7	79,7	79,7	79,7	0,0	0,0

Tab. 4 Indeksi i Çmimeve të Prodhimit të produkteve për eksport

		2010=100						
NVE	Përshkrimi	Peshat	Prill-19	Maj-19	Qershor-19	II-19	II-19 / I-19	II-19 / II-18
	Gjithsej	100,0	105,6	105,4	103,5	104,9	-0,7	-3,3
B	Industria Nxjerrëse	18,0	112,5	111,4	101,6	108,5	7,0	-2,3
06	Nxjerrja e naftës bruto dhe gazit natyror	9,1	122,2	123,3	102,8	116,1	13,7	1,1
07	Nxjerrja e mineraleve metalore	8,1	92,3	88,6	92,2	91,1	-1,5	0,3
08	Nxjerrja e mineraleve të tjera nga minierat apo karrierat	0,7	99,7	98,6	99,1	99,1	-2,0	-2,0
C	Industria Përpunuese	78,0	104,3	104,2	104,2	104,2	-2,6	-2,6
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	9,5	98,9	98,9	98,9	98,9	-1,1	0,1
11	Prodhimi i pijeve	0,7	98,3	98,3	98,8	98,5	-1,5	-1,5
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	0,2	109,9	109,9	109,9	109,9	-3,5	-3,5
13	Përpunimi i tekstileve	0,8	106,1	106,1	106,1	106,1	-2,5	-5,1
14	Konfeksionimi i veshjeve	11,0	107,3	107,4	107,5	107,4	-1,0	1,4
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	11,5	108,9	108,9	109,0	108,9	0,3	0,6
16	Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobiljeve; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi	1,1	103,6	103,6	103,6	103,6	-0,6	1,2
17	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letre	4,0	113,9	113,9	113,9	113,9	3,1	1,5
19	Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës	1,0	103,4	103,4	103,4	103,4	-0,1	2,0
20	Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike	1,4	122,5	122,5	122,7	122,6	-0,3	-0,2
21	Përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutikë	0,2	99,7	102,4	102,4	101,5	-0,9	-2,9
22	Prodhimi i produkteve të kauçukut dhe plastikës	1,1	120,2	120,2	120,2	120,2	0,1	-2,1
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	5,7	150,1	148,4	148,9	149,1	-1,1	-3,3
24	Metalurgjia	18,3	92,8	92,8	92,8	92,8	-9,5	-9,8
25	Prodhimi i produkteve metalike të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve	6,0	112,4	112,4	112,4	112,4	-1,5	-3,8
26	Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë	0,3	116,7	116,5	113,9	115,7	-0,5	-2,2
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	1,3	97,9	97,9	97,9	97,9	-2,9	-4,1
28	Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve p,k,t	0,6	114,8	114,8	114,7	114,7	0,1	-0,1
29	Prodhimi i mjeteve të transportit, rimorkiove dhe gjysëmrimorkiove	0,1	100,5	100,5	100,5	100,5	-0,7	-0,6
31	Prodhimi i mobiljeve	2,1	104,4	104,2	104,2	104,3	-0,3	-0,7
32	Industri të tjera p,k,t	1,1	90,1	90,1	90,1	90,1	-1,1	-2,6
E	Furnizimi me ujë, aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	4,1	86,6	87,6	87,2	87,1	0,7	1,2
38	Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve	4,1	86,6	87,6	87,2	87,1	0,7	1,2

Metodologjia

INSTAT llogarit dhe publikon:

- Indeksin e Çmimeve të Prodhimit Gjithsej
- Indeksin e Çmimeve të Prodhimit të Produkteve për Tregun vendas,
- Indeksin e Çmimeve të Prodhimit për Eksport

Fusha e mbulimit:

Seksioni B - Industri Nxjerrëse

Seksioni C – Industri Përpunuese

Seksioni D - Furnizimi me Energji Elektrike, Gaz e Avull dhe me Ajër të Kondicionuar

Seksioni E - Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve

Llogaritja e indeksit

Indekset llogariten për çdo produkt të klasifikuar sipas Nomenklaturës së Produkteve (NP 2008) në nivel 6-shifror dhe publikohen sipas degëve të ekonomisë në nivel 2-shifror. Rinovimi i shportës së ndërmarrjeve dhe produkteve realizohet çdo vit duke përdorur rezultatet e Anketës Strukturore pranë Ndërmarrjeve Ekonomike jo Bujqësore. Përcaktimi i peshave të produkteve me destinacion tregun vendas mbështetet në rezultatet e po kësaj ankete, ndërsa peshat e produkteve me destinacion eksportin mbështeten në të dhënat statistikore të Tregtisë së Jashtme.

Duke filluar nga tremujori i dytë 2014 e në vazhdim Indeksi i Çmimeve të Prodhimit ka si periudhë referuese vitin 2010 = 100. Metoda e llogaritjes së indeksit është metoda zinxhir (Laspeyres - chain index) sipas së cilës, çmimi i produktit në periudhën korente (y) krahasohet me çmimin e muajit Dhjetor të vitit të mëparshëm (y – 1);

$$I_{2010}^{y,m} = \frac{100}{\frac{1}{12} \sum_{M=JAN}^{DEC} I_{2009 Dec}^{2010,M}} \times \prod_{Y=2010}^{y-1} I_{Y-1,dec}^{Y,dec} \times I_{y-1,dec}^{y,m}$$

- Pjesa e parë e formulës tregon ndryshimin e çmimeve të muajit Dhjetor 2010 krahasuar me mesataren e çmimeve në vitin 2010 (2010 = 100).
- Pjesa e dytë e formulës tregon lëvizjen zinxhir të indeksit të çmimeve nga muaji Dhjetor 2010 deri në periudhën y-1.
- Pjesa e tretë e formulës tregon ndryshimin e çmimeve nga muaji Dhjetor y-1 në muajin m të vitit y.

Matësit e Indeksit

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e çmimit midis tremujorit korent dhe të njëjtit tremujor të vitit të kaluar. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve vjetore në nivelet e çmimeve por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të çdo tremujori.

Ndryshimi tremujor krahason nivelet e çmimit të dy tremujorëve të fundi.